



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranimar / Dorezuar Prilimjen / Prodato Received / Delivered	11. 05 2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	QKMSHCK	4191/2023	Sasia Kolicina Quantity
			113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr. 560/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga; Eshref Shabani kryetar-Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtarë, Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A. Nr. 560/2023, të datës 27.03.2023, të ankuesit \_\_\_\_\_ me adresë \_\_\_\_\_

kundër organit të punësimit Policia e Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 11.05.2023 mori këtë

**V E N D I M**

**I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A. Nr. 560/2023, të datës 27.03.2023, të ankuesit \_\_\_\_\_**

**II. Mbetet në fuqi përgjigja me numër referencë 07/1-01-SAP-P/3494, i Shefes së Njesisë së Burimeve Njerëzore të Policisë së Kosovës.**

**A r s y e t i m**

Ankuesi \_\_\_\_\_ me datë 27.03.2023 me numër protokolli 3003/2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me kompensimin e një page me rastin e vdekjes së familjarit të ngushtë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 30.03.2023, ka

proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Polica e Kosovës. Ndërsa me datë 20.04.2023, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë të ankuesit si dhe shkresat lidhur me lëndën.

*Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 560/2023, e datës 27.03.2023, me numër protokolli 3000/2023 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigje në kërkesë e datës 20.03.2023; Kontrata e punës e datës 19.08.2014; kërkesë e datës 02.03.2023; Certifikata e vdekjes e datës 24.04.2023; Certifikatë e datës 28.02.2023; Përgjigje në ankesë e datës 20.04.2023.*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesi është e pa bazuar sepse:

Bazuar ne shkresat e lëndës del se ankuesi me datë 02.03.2023, ka parashtruar kërkesë për kompensimin në rastin e vdekjes së ngushtë të anëtarit përkatësisht (nenës), ndërsa Shefja e Njësisë së Personelit e Policisë se Kosovës, me datë 20.03.2023, i ka përgjigjur në kërkesën me arsyetimin se me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, janë shfuqizuar dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore, për kompensimin në rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, dhe se kërkesa e juaj është pranuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, prandaj kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi që ka shqyrtuar bazën ligjore ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuara sepse në kohën e parashtrimit të ankesës në Këshill është në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë..

Ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, kolegji ka konstatuar se lidhur me për kompensimin e kompensimin në rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, tani kemi në fuqi ligjin material Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, prandaj pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuar dhe në kundërshtim me nenin 45, paragrafi 1, nen paragrafi 1.1, dhe nenin 2, të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, ku përcaktohet se; 1. *Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen:1.1.Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil;2. Me hyrje në fuqi të këtij ligji shfuqizohet gjithashtu çdo dispozitë e ligjit apo e aktit nënligjor tjetër që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorie tjetër në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar shprehimisht për t'u nxjerr nga dispozitat e këtij ligji.*

Kolegji konstaton se nga data e miratimit të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, kompensimin në rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, zbarohet dispozitat e nenit 2, paragrafi 1dhe 2 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, ku përcaktohet se; 1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, përjashtimisht Agjencisë Kosovare për Inteligjencë. 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Shefja e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Policisë së Kosovës, në rastin e nxjerrjes së përgjigjes së 20.03.2023, ka vepruar në pajtim me dispozitat Ligji nr. 06/1 -114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, lidhur me rastin e ankuesit

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

*Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës*  
*Lënda A.nr. 560/2023*

*Rushit KAJTAZI*  
Procesmbajtës

*Eshtref SHABANI*  
Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës ;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës ;
- Arkivit të KPMSHCK-së

